



Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të datës 4 Qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 Qershor 2008, nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019, nenit 5 pika 1.paragrafi 1.3, nenit 6 paragrafi 3, nenit 13, nenit 21 paragrafi 5 dhe 6 dhe nenit 22 të Rregullores QRK NR.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2024 të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZONËN KADASTRALE BABUSH I MUHAXHERËVE

Neni 1

MIRATOHET oferta e përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë:

1.Relux SH.P.K me Numër Unik Identifikues 810805749 me adresë: Magjistranja Prishtinë-Shkup km6 Llapnasellë-Graçanicë, me pronar Ramiz Gashi, shfrytëzues i pronës të paluajtshme të komunës në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve.

2.Prona e paluajtshme e komunës gjendet në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve, e përshkruar në evidencen kadastrale përkatëse, si në tabelën në vijim:

Nr.	Pronar	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Sipërfaqe për shfrytëzim m ²
1.	Komuna Lipjan	P-71409059-00559-9	Babush i Muhaxherëve	40000

3. Shfrytëzimi i pronës komunale do të jetë pa kompensim në afat prej 99 vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi..

4. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës të paluajtshme të komunës, destinohet kryesisht për ndërtimin e fabrikës për prodhimin e materialeve ndërtimore, sipas projektit ideor arkitekture-objekt industrial Relux SH.P.K.

Neni 2

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme në ZK- Babush i Muhaxherëve.

Neni 3

Pas përfundimit të afatit të kontratës, prona i kthehet titullarit të pronës- Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Zyra e Kryetarit-Sektorit Pronëso- Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati i Inspektionit, Drejtorati i Infrastrukturës dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

A r s y e t i m

Baza juridike për ta propozuar dhe miratuar këtë propozim-Vendim është e përcaktuar me dispozitat të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, të Rregullores QRK NR.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës Nr.15-463/06-22761 datë 08.05.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në zonën kadastrale Babush i Muhaxherëve.

Bazuar në aplikacionin dhe dokumentet e tjera përcjellëse si në shkresat e lëndës të datës 15.08.2024 Nr.01-463/02-40850 të ofertuesit, Relux SH.P.K me Numër Unik Identifikues 810805749 me adresë: Magjistratja Prishtinë-Shkup km6 Llapnasellë-Graçanicë, me pronar Ramiz Gashi, Komisioni Vlerësues gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka vlerësuar se ofertuesi i lartëcekur, i ka plotësuar kushtet për marrjen e parcelës komunale P-71409059-00559-9 me sipërfaqe 40000 m² në ZK-Babush i Muhaxherëve, në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës konform dispozitave të Ligjit Nr.06/L-092.

Në Njoftimin Publik datë 31.07.2024 Nr.01-462/01-36956 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në ZK-Babush i Muhaxherëve, Komisioni Vlerësues ka përzgjedhur me datë 06.09.2024 Nr.01-462/01-44871 si në shkresat e lëndës, ofertuesin Relux SH.P.K, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK-Babush i Muhaxherëve, për ndërtimin e fabrikës për prodhimin e materialeve ndërtimore, sipas projektit ideor arkitektura-objekt industrial Relux SH.P.K.

Në raportin e Komisionit Vlerësues datë 19.09.2024 Nr.15-052/01-46381 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK-Babush i Muhaxherëve, për vlerësimin e ofertave sipas Njoftimit publik Nr.01-462/01-36956 datë 31.07.2024, është konstatuar se nuk ka pasur asnjë ankesë pranë Komisionit kompetent për shqyrtimin e ankesave dhe përkitazi me këtë çështje, Komisioni Vlerësues ka vazhduar zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës konform dispozitave të Ligjit Nr.06/L-092.

Prandaj, duke u bazuar në dhënat e lartëcekura dhe konform dispozitave ligjore në fuqi, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij propozim-Vendimi.

01 Nr. 462/01-46475

Lipjan, më 20.09.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





Në mbështetje të nenëve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28 e datës 04 qershor 2008, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8, 14 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019 dhe nenit 13 të Rregullorës (QRK) Nr 09.2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës të datës 13.08.2020 dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 08.05.2024, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZONËN KADASTRALE BABUSH I MUHAXHERËVE

Neni 1

1. Me këtë Vendim jepen në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik paluajtshmeritë-pronat komunale që gjenden në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve të përshkruara si në vijim:
 - 1.1. Njësia kadastrale P-71409059-00559-9 me sipërfaqe 40000 m² ZK Babush i Muhaxherëve, Komuna Lipjan
 - 1.2. Njësia kadastrale P-71409059-00559-10 me sipërfaqe 20000 m² ZK Babush i Muhaxherëve, Komuna Lipjan
 - 1.3. Njësia kadastrale P-71409059-00559-11 me sipërfaqe 10000 m² ZK Babush i Muhaxherëve, Komuna Lipjan
 - 1.4. Njësia kadastrale P-71409059-00559-12 me sipërfaqe 13137 m² ZK Babush i Muhaxherëve, Komuna Lipjan
 - 1.5. Njësia kadastrale P-71409059-00559-15 me sipërfaqe 11172 m² ZK Babush i Muhaxherëve, Komuna Lipjan

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfytëzim të pronave komunale siç përcaktohet në nenin 1 të këtij vendimi, bëhet në mënyrë që subjekteve të interesuara të i'u mundësohet të ofertojnë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të biznesit të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të Komunës së Lipjanit, sipas standardeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Pronat e paluajtshme komunale sipas nenit 1 të këtij Vendimi jepen në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite nëpërmjet procedurës së Njoftimit publik nga ana e Komisionit Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal.

Neni 4

Zgjedhja e ofertës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të komunës, bazohet në kriteret e përcaktuara në nenin 20 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës të paluajtshme të komunës sipas nenit 1 të këtij Vendimi të regjistroj në librat kadastral si pronë të dhënë në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset: Zyra e Kryetarit-Sektorit Pronëso- Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspeksion.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Nr. 15-463/06-22761

Lipjan, më 08.05.2024

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN





Republika e Kosovës
Republica Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedietit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure /
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

EKSTRAKTI NGA CERTIFIKATA / IZVOD IZ CERTIFIKATA / EXTRACT OF CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : Komuna e Lipjanit

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 214-2024n
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 22.04.2024 - 14:36
Komuna / Opština / Municipality: LIPJAN / LIPJAN / LIPJAN
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastrol Office: LIPJAN / LIPJAN / LIPJAN

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i afatimit (biznesi) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesi Liteni broj/broj poslovanja ID. No.	Shteti i shtetësisë apo regjistrimit DZ-ava dZanvljanstva ili ulanvljanja Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osntvanja Date of Birth/Establishmen t	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azhurirano Updated
Komuna e Lipjanit			/	600371588	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO		30.12.2020	

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi Postar Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostni adrese Address Details	Adresa ejetër Druga adresa Other address	Azhuruar Azhurirano Updated
/		SHQIPËRIA		

B. NEPSIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

Njësia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale Katastarska zona Cadastral zone	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type	Kat/ Kover Et-Sprat of Spratova Floor number	Vendi i qeshtur Zvano mesto Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shtyrëzimi aktual/Kultura- Klasa Aktuelna upotreba/ Kultura-Klasa Actual use/Culture-class	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azhuruar Azurnano Updated
P-71409059-00559-9	LIPJAN / LIPJAN / LIPJAN	Babush I Muhaxherëve / Muhadzer Babus / Babushi I Muhajterve	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / R		BALKAN / BALKAN / BALKAN	40000	Bujqësore - Kulloset - Kullosë E Klasës 4 / / Poljopritredno - Pashnjaci - Pashnjak 4 Klase / / Agricuture - pasture - 4th Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drazvina / Single possessor	22.04.2024
P-71409059-00559-10	LIPJAN / LIPJAN / LIPJAN	Babush I Muhaxherëve / Muhadzer Babus / Babushi I Muhajterve	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / R		BALKAN / BALKAN / BALKAN	20000	Bujqësore - Kulloset - Kullosë E Klasës 4 / / Poljopritredno - Pashnjaci - Pashnjak 4 Klase / / Agricuture - pasture - 4th Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drazvina / Single possessor	22.04.2024
P-71409059-00559-11	LIPJAN / LIPJAN / LIPJAN	Babush I Muhaxherëve / Muhadzer Babus / Babushi I Muhajterve	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / R		BALKAN / BALKAN / BALKAN	10000	Bujqësore - Kulloset - Kullosë E Klasës 4 / / Poljopritredno - Pashnjaci - Pashnjak 4 Klase / / Agricuture - pasture - 4th Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drazvina / Single possessor	22.04.2024
P-71409059-00559-12	LIPJAN / LIPJAN / LIPJAN	Babush I Muhaxherëve / Muhadzer Babus / Babushi I Muhajterve	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / R		BALKAN / BALKAN / BALKAN	13137	Bujqësore - Kulloset - Kullosë E Klasës 4 / / Poljopritredno - Pashnjaci - Pashnjak 4 Klase / / Agricuture - pasture - 4th Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drazvina / Single possessor	22.04.2024
P-71409059-00559-13	LIPJAN / LIPJAN / LIPJAN	Babush I Muhaxherëve / Muhadzer Babus / Babushi I Muhajterve	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / R		BALKAN / BALKAN / BALKAN	92601	Bujqësore - Kulloset - Kullosë E Klasës 4 / / Poljopritredno - Pashnjaci - Pashnjak 4 Klase / / Agricuture - pasture - 4th Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drazvina / Single possessor	22.04.2024

Printuar nga / Odsampari od / Printed by: Mir-Shala | Personi/Osoba/Person: Komuna e Lipjanit |






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY
KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Kataslarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : LIPJAN
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Babush I Muhaxherëve

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71409059-00559-9	Parcelë / Parcela / Parcel	40000
P-71409059-00559-10	Parcelë / Parcela / Parcel	20000
P-71409059-00559-11	Parcelë / Parcela / Parcel	10000
P-71409059-00559-12	Parcelë / Parcela / Parcel	13137



Shkalla/Razmera/Scale: 1:3601

Punoi/Obradio/Created: Ilir Shala
Nënshkrimi/Polpis/Signature: 
Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 22.04.2024
Koha/ Vreme/ Tlme: 02:55:32

DOKUMENTI I DALJES IZLAZNA OUTGOING
 MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TE PUSHTETIT LOKAL
 Ministry of Local Government Administration
 Nr. 070-327/6
 Data: 21.06.2024

Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government Administration

Për:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Ud. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erblin Hetemi, Ud. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Data: 20.05.2024 VI-020-327
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafaj, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Leonora Bajrami, Zyrtare për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Lipjanit	
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të komunës së Lipjanit	

I nderuar Kryetar,
 I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren Nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nënin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim paraparak 15 Nr.463/06-22761 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në zonën kadastrale Babushi i Muhaxhereve
I miratuar më datë: 08.05.2024
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 10.05.2024

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me datë 08.05.2024, ka miratuar Vendimin paraprak 15 Nr.463/06-22761 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në zonën kadastrale Babushi i Muhaxhereve i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit është bazuar me nenin 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenin 8 dhe nenin 14 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 13 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Vendimi paraprak 15 Nr.463/06-22761 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në zonën kadastrale Babushi i Muhaxhereve është miratuar në mbledhjen e Kuvendit me datë 08.05.2024, me 24 vota për 0 kundër dhe 2 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbete në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10 e datës 03 prill 2019, nenit 17 të Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit INr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 08.05.2024, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK BABUSH I MUHAXHERËVE

Neni 1

Përbërja e Komisionit

1. Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve 15Nr. h63/06-22761 i datës 08.05.24 (në vazhdim të tekstit: Komisioni në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve, prej të cilëve 2 (dy) anëtarë të propozuar nga Kryetari i Komunës nga përbërja e ekzekutivit të Komunës, 2 (dy) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjektet politike dhe 1 (një) anëtar nga sektori jo qeveritar lokal.

2. Anëtarë të Komisionit emërohen, si vijon :

1. Latif Ramadani, nga ekzekutivi i Komunës,
2. Rexhep Rexhepi, nga ekzekutivi i Komunës,
3. Armend Grajqevci, nga subjekti politik LDK,
4. Lulzim Rustemi, nga subjekti politik PDK,
5. Arbnora Dedushi, nga sektori joqeveritar lokal

Neni 2

Zgjedhja e Kryesuesit

Anëtarët e Komisionit me shumicë të votave, e zgjedhin Kryesuesin e Komisionit i cili e kryeson punën e Komisionit.

Neni 3

Mandati i anëtarëve

Mandati i anëtarëve të Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve _____ të datës _____.

Neni 4

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni, për të zbatuar Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës të cekur më lartë me të cilin është vendos për pronën e cila do jepet në shfrytëzim, është përgjegjës për zbatimin e procedurave të parapara me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj me akte nëligjore dhe me këtë vendim do ti ndihmojnë në kuadër të kompetencave të tyre Zyra Kryetarit të Komunës – Sektori pronësor-juridik.

Neni 6

Kompenzimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ofertave të një Njoftimi publik do të kompenzohen në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse. Kompenzimi do të bëhet vetëm për anëtarët e komisionit të cilët nuk e kanë të ndaluar kompenzimin për kryerjen e shërbimeve shtesë konform dispozitave të legjisllacionit në fuqi.

Neni 7

Hyrja në fuqi

1. Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Nr. 15-463/06-22763

Lipjan, më 08.05.2024

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit





REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN



Pranuar me: Primljeno:	31.07.2024	
Mjësia Jednicat	Numri Braj	Shtojca Dodatak
01-462/01-	36956	

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/ 03 Prill 2019, neneve 14 dhe 20 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për caktimin e procedurave të dhënjës në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës e datës 10 gusht 2020, Vendimit paraparak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve Nr-15-463/06-22761 të datës 08.05.2024 dhe Vendimit për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës në ZK Babush i Muhaxherëve Nr.15-463/06-22763, të datës 08.05.2024 në ZK Babush i Muhaxherëve, Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, shpallë:

**NJOFTIM PUBLIK
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME
TË KOMUNËS - ZK BABUSH I MUHAXHERËVE**

Komuna e Lipjanit në pajtim me Vendimin paraparak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve Nr-15-463/06-22761 të datës 08.05.2024 dhe Vendimin për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës në ZK Babush i Muhaxherëve Nr.15-463/06-22763, të datës 08.05.2024, jep në shfrytëzim afatgjatë për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite, pronat e paluajtshme me shënimet në tabelën si vijon:

Nr.	Pronar	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Sipërfaqe për shfrytëzim m ²
1.	Komuna Lipjan	P-71409059-00559-9	Babush i Muhaxherëve	40000
2.	Komuna Lipjan	P-71409059-00559-10	Babush i Muhaxherëve	20000
3.	Komuna Lipjan	P-71409059-00559-11	Babush i Muhaxherëve	10000
4.	Komuna Lipjan	P-71409059-00559-12	Babush i Muhaxherëve	13137
5.	Komuna Lipjan	P-71409059-00559-15	Babush i Muhaxherëve	11172

L.P. R.R. A.G L.B. A.D

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të cekura më lartë është krijimi i hapësirës për investitorët serioz për investim në biznese prodhuese-përpunuese, objekte tregtare apo të ngjajshme, sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

Pronat komunale në këtë zonë, ofrohen për shfrytëzim sipas Hartës Zonale të Komunës për zhvillim të industrisë (industri e rëndë, e mesme dhe e lehtë), si dhe për shfrytëzime komerciale të cilat janë në shërbim të industrisë.

Shfrytëzimet e lejuara:

- Industri e lëndës së parë,
- Industri e prodhimeve të rënda.
- Industri e prodhimeve të lehta.
- Shërbim tregtar.
- Shërbim profesional financiar dhe i informacionit.

Aplikuesit, në momentin e konkurimit në pajtim me Rregulloren për Taksa Komunale duhet të paguajnë taksën në shumë prej 100 € (njëqind euro), për çdo parcelë kadastrale të ofertuar ndërsa për secilën parcelë nevojitet pliko ose zarfë e veçantë, dhe jashtë kuvertës në njëren anë duhet të shënohet Zona Kadastrale Babush i Muhaxherëve.

Aplikacioni i kompletuar bashkë me ofertën në kovertë të mbyllur dorzohen në ndërtesën e Komunës kati perdhesë, Qendra për shërbime për qytetarë sporteli 1 dhe 2, në afat prej 15 ditësh kalendarike pas ditës së publikimit të këtij Njoftimi, konkretisht njoftimi është i hapur deri më datën 15.08.2024 në ora 16:00

Hapja publike e ofertave do të bëhet në ndërtesën e Komunës në Sallën e Kuvendit Komunal me datë: 16.08.2024 duke filluar në ora 10:00 .

Kriteret për zgjedhjen e ofertave

Zgjedhja e ofertës më të favorshme për Komunën për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, bazohet në kriteret vijuese:

1. Vlera e investimit;
2. Numri i të punësuarve nga investimi;
3. Lloji i investimit që konsiderohet me interes dhe prioritet për komunën;
4. Përfitimi financiar dhe ekonomik i komunës;
5. Të plotësojë kushtet dhe kriteret e përcaktuara mjedisore;
6. Të jetë në harmoni me Hartën Zonale të Komunës së Lipjanit.

Pjesëmarrësve në konkurim u garantohet e drejta që të:

- Informohen lidhur me procedurat e njoftimit publik;
- Të shohin pronën që do të jetë objekt i dhënies në shfrytëzim;
- Të kenë qasje në dokumentacionin e pronës;
- Të tërhiqen nga konkursi jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave

L.P. P.P. A.G L.B. A.D

Oferta duhet të përmbajë: shënimet e ofertuesit, numrin e këtij Njoftimi publik, datën e përpilimit të ofertës, titullin OFERTË, shënimin mbi pronën për të cilën ofertohet, emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e ofertuesit për personin fizik, ndërsa për personin juridik edhe funksionin e personit përgjegjës.

Oferta e personit fizik duhet të nënshkruhet nga personi fizik, ndërsa oferta e personit juridik nënshkruhet dhe vulloset nga personi përgjegjës i personit juridik.

Oferta për pronën e caktuar duhet të vendoset në kuvertë të mbyllur për secilën parcelë kadastrale të ofertuar.

Koverta në faqen e parë duhet të përmbajë shënimin:

**Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme ZK Babush i
Muhaxherëve sipas Njoftimin publik nr.1 të datës 31.07.2024**

Tërheqja e aplikacioneve mund të bëhet në ndërtesën e Komunës kati përdhësë në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli Nr.1 dhe 2 në formën fizike, dhe në formë elektronike nga Webfaqja e Komunës .

Aplikacioni bashkë me ofertën në kovertë të mbyllur për secilën parcelë kadastrale dorëzohet në ndërtesën e Komunës kati përdhësë në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli nr.1 dhe 2 në afat prej 15 ditësh kalendarike nga dita e publikimit të këtij Njoftimi, konkretisht njoftimi është i hapur deri me datën 15.08.2024 në orën 16:00.

Ofertat të pakompletuara të paprecizuara, të panënshkruara nuk do të shqyrtohen.

Gjatë hapjes së ofertave marrin pjesë nënshkruesit e ofertave përkatësisht të autorizuarit e tyre me autorizim noterial.

Njoftimi për ofertën e përzgjedhur do t'i dërgohet fituesit pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe do të publikohet në Uebfaqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

Informatat shtesë mund të merren në Ndërtesën e Komunës, kati i tretë, Sektori pronësor-juridik ose në tel 038-200-41-507.

Komisioni

- 1.Latif Ramadani
- 2.Rexhep Rexhepi
- 3.Armend Grajqevci
- 4.Lulzim Rustemi
- 5.Arbnora Dedushi

Me datë: 31.07.2024



REPUBLIKA E KOSOVES
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVO

Pranuar me Primljeno	06.09.2024	
Njësia Jednicë:	Numri Brez	Shtojca Dodatak
01-462/01-44871		



KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
 MUNICIPALITY OF LIPJAN

KOMISIONI VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK BABUSH I MUHAXHERËVE

Në mbështetje të nenit 17 dhe 19 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10/03 Prill 2019, neneve 14, 20 dhe 21 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020, Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës Nr.15-463/06-22761 të datës 08.05.2024 dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.15-467/22763 të datës 08.05.2024 për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës në ZK Babush i Muhaxherëve, Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit shpallë këtë:

NJOFTIM
PËR PËRZGJEDHJEN E OFERTAVE TË NJOFTIMIT PUBLIK NR.01-462/01-36956 TË DATËS 31.07.2024

I. **NJOFTOHEN** të gjithë aplikuesit dhe publiku se për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale në njoftimin publik për Zonën Kadastrale në Babush i Muhaxherëve, procesi i vlerësimit të ofertave për Konkursin Publik Nr. 01-462/01-36956 të datës 31.07.2024 ka përfunduar duke rekomanduar si përfitues ofertuesit si në vijim:

- RELUX SH.P.K. me Numër Unik Identifikues 810805749 me adresë: Magjistrallja Prishtinë- Shkup km 6, Llapnasellë 10500 Graçanicë, nga komisioni vlerësues është rekomanduar si përfitues për parcelën kadastrale si në vijim:

Nr.	Pronar	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Sipërfaqe për shfrytëzim në m ²
1.	P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409059-00559-9	Babush i Muhaxherëve	40000 m ²

L.R.R.R A.G L.B. A.D

- **MERCOM COMPANY SH.P.K.** me Numër Unik Identifikues **810298548** me adresë: Rruga „ Fehmi Agani“ hyrja 96, Kati 1, nr.1 Zona , Prishtinë, nga komisioni vlerësues është rekomanduar si përfitues për parcelën kadastrale si në vijim:

Nr.	Pronar	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Sipërfaqja për shfrytëzim në m ²
2.	P.Sh. Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409059-00559-15	Babush i Muhaxherëve	11172 m ²

- Parcelat Kadastrale nr. P-71409059-00559-10, P-71409059-00559-11 dhe P-71409059-00559-12, nuk ka përfitues të rekomanduar.

- II. Palët e pakënaqura nga procesi i vlerësimit të ofertave nga Komisioni, prej ditës së pranimit të këtij njoftimi kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë brenda afatit prej shtatë (7) ditë kalendarike pranë Komisionit për shqyrtimin e ankesave.
- III. Pas përfundimit të afatit për parashtrimin e ankesave dhe shqyrtimit të tyre, Kuvendit Komunal i propozohet të miraton ofertat e përzgjedhura nga Komisioni Vlerësues.


1. Latif Ramadani, Kryesues i Komisionit

2. Rexhep Rexhepi, Anëtar

3. Armend Grajqevci, Anëtar

4. Lulzim Rrustemi, Anëtar

5. Arbnora Dedushi, Anëtare



Handwritten signatures of the five members of the Commission, each on a horizontal line.

Numër: 01-462/01-44871

Datë: 06.09.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
 KOMUNA E LIPLJANIT
 REPUBLIKA KOSOVO
 OPŠTINA LIPLJAN



KOMUNA E LIPLJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
 MUNICIPALITY OF LIPLJAN

Pranuar me: Prilipeno:	19.09.2024	
Njësia Jediniça	Numri Seri	Shtojca Dodatak
15-052/01-46381		

Datë:	19.09.2024
Për:	Daut Azemi - Kryesues i Kuvendit të Komunës
Kopje:	Imri Ahmeti - Kryetar i Komunës së Lipjanit
Nga:	Anëtarët e Komisionit Vlerësues të themeluar me Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr.15-463/06-22763 të datës 08.05.2024
Lënda:	Raporti i Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës - ZK Babush i Muhaxherëve për vlerësimin e ofertave sipas Njoftimit publik Nr.01-462/01-36956 të datës 31.07.2024

Duke u bazuar në Ligjin Nr.06/L-92 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.15-463/06-22761 të datës 08.05.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të Komunës ZK-Babush i Muhaxherëve, si dhe pas kalimit të afatit ligjor për ushtrimin e ankesave, nuk ka pasur asnjë ankesë, Komisioni Vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, prezanton:

**Raportin
 e vlerësimit të ofertave sipas Njoftimit publik 01-462/01-36956 të datës 31.07.2024**

Në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.15-463/06-22761 të datës 08.05.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të Komunës ZK-Lipjan, me Njoftimin publik Nr. 01-462/01-36956 të datës 31.07.2024 janë shpallur për dhënie në shfrytëzim pronat komunale si:

1. P-71409059-00559-9 me sipërfaqe 40000m²
2. P-71409059-00559-10 me sipërfaqe 20000m²
3. P-71409059-00559-11 me sipërfaqe 10000m²
4. P-71409059-00559-12 me sipërfaqe 13137m²
5. P-71409059-00559-15 me sipërfaqe 11172m²

Komisioni Vlerësues pas përmbylljes së afatit për aplikim të përcaktuar me Njoftimin publik ka pranuar tri (3) oferta.

Të gjitha ofertat janë vlerësuar sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe lidhur me këte Komisioni ka mbajtur tetë (8) takime pune. Komisioni me datën 06.09.2024 ka përfunduar vlerësimin e ofertave dhe në bazë të kriterve të përcaktuara janë rekomanduar si përfitues ofertuesit si në vijim:

- **RELUX SH.P.K** me Numër Unik Identifikues 810805749 me adresë: Magjistrallja Prishtinë-Shkup km 6 Llapnasellë10500 Graçanicë, është rekomanduar si përfitues për parcelen P-71409059-00559-9 ZK Babush i Muhaxherëve me sipërfaqe 40000 m².

- **MERCOM COMPANY SH.P.K.** me Numër Unik Identifikues 810298548 me adresë: Rruga „ Fehmi Agani“ hyrja 96, Kati 1, nr.1 Zona , Prishtinë, është rekomanduar si përfitues për parcelën P-714090059-00559-15 ZK Babush i Muhaxherëve me sipërfaqe 11172 m².

L. R. R. A.G L. R. A.D

- Parcelat Kadastrale nr. P-71409059-00559-10, P-71409059-00559-11 dhe P-71409059-00559-12, nuk ka të rekomanduar, pasi që nuk kishte asnjë ofertë për këto parcela.

Njëkohësisht, Komisioni ka përgatitur “Njoftimin për përzgjedhjen e ofertës” i cili është publikuar me datën 06.09.2024.

Duke pasur parasysh proceset e zhvilluara, Njoftimi për përzgjedhjen e ofertës Nr.01-462/01-44871 i datës 06.09.2024, administrativisht është akt përfundimtar.

Në Shtojcë të këtij Raporti bashkëngjesim dokumentet:

1. Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr.15-463/06-22761 të datës 08.05.2024.
2. Vendimin Nr.15-463/06-22763 për themelimin e Komisionit vlerësues.
3. Njoftimin publik 01-462/01-36956 të datës 31.07.2024.
4. Njoftimi për përzgjedhjen e ofertës Nr.01-462/01-44871 i datës 06.09.2024.

Shënim: Të gjitha shkresat tjera lidhur me shqyrtimin e ofertave, duke përfshirë edhe ofertat e parashtruara nga palët janë dorëzuar në Sektorin për çështje pronësore – juridike.

Me respekt,

Anëtarët e Komisionit:

Latif Ramadani

Rexhep Rexhepi

Armend Grajqevci

Lulzim Rustemi

Arbnora Dedushi

